

**Raport vlerësimi lidhur me
zbatimin e Rregullave të
Mekanizmit Balancues në
fazën Dry Run**

(1 janar 2021 – 31 janar 2021)

Përmbajtje

1. Hyrje.....	3
2. Prokurimi i kapacitetit rezervë gjatë muajit janar 2021.	4
2.1. Pjesëmarrja në testime.....	4
2.2. Kërkesa e OST, Ofertat e OShB-ve dhe sasia e kontraktuar.....	4
2.3. Çmimet mesatare të kapacitetit rezervë të ofruar dhe të kontraktuar.....	10
2.4. Kostot e OST sh.a për prokurimin e kapacitetit rezervë.	13
3. Prokurimi i energjisë balancuese gjatë muajit janar 2021.....	16
3.1. Pjesëmarrja në testime.....	16
3.2. Ofertat e OShB-ve, nevojat e sistemit dhe sasia e aktivizuar.....	16
3.3. Çmimet mesatare të energjisë balancuese të ofruar dhe të aktivizuar.....	19
3.4. Kostot e OST sh.a dhe OShB-ve për aktivizimin e energjisë balancuese.	25
4. Çmimi i disbalancave dhe kostot nga disbalancat gjatë muajit janar 2021.....	28
4.1. Çmimi i disbalancës.	28
4.2. Kostot e OST dhe PPB-ve që rrjedhin nga Disbalancat.....	35
4.2.1. Kostot e OST.....	36
4.2.2. Kostot e PPB-ve.....	39
5. Përfundime.....	42

1. Hyrje

Ky Raport është hartuar referuar Vendimit të ERE, Nr.106, datë 02.07.2021 mbi miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, në zbatim të pikës 5 të tij ku citohet se “*OST sh.a., të raportojë dhe dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.*” si dhe referuar Vendimit të ERE nr. 275, datë 28.12.2021 mbi “*kërkesën e shoqërisë OST sh.a për shtyrje të afatit të hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2021*”, në zbatim të pikës 4 të tij ku citohet se “*OST sh.a., të raportojë dhe dokumentojë çdo muaj në lidhje me ecurinë e zbatimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.*”

Raporti paraqet një vlerësim të detajuar lidhur me zbatimin e Rregullave të TShB pa efekte financiare për periudhën 1 janar 2021 – 31 janar 2021. Raporti përmban informacion të detajuar për çdo hap të kryer gjatë fazës Dry Run përgjatë muajit janar 2021 dhe konsiston në informacion lidhur me:

- Procesin e Ankandit të Angazhimit për Disponueshmëri.
- Procesin e Ankandit të Angazhimit për Shpërndarje.
- Energjinë balancuese dhe çmimin e energjisë balancuese.
- Disbalancat dhe çmimin e disbalancave.
- Kostot e OST dhe pjesëmarrësve të tregut.

Gjithashtu ky raport analizon çmimet e kapacitetit rezervë, çmimet e energjisë balancuese dhe çmimet e disbalancave që rezultojnë nga testimet duke i krahasuar ato me çmimet aktuale si dhe me çmimet e vendeve të rajonit duke na ofruar një tablo më të qartë. Po ashtu analizohen dhe krahasohen kostot e OST dhe pjesëmarrësve të tregut që rezultojnë nga testimet kundrejt atyre aktuale.

2. Prokurimi i kapacitetit rezervë gjatë muajit janar 2021.

Prokurimi i kapacitetit rezervë u testua nëpërmjet kryerjes së Ankandit të Angazhimit për Disponueshmëri. Testimet për muajin janar 2021 u realizuan në tre javë, ku rezultatet janë si në vijim për secilën javë testimesh ku janë paraqitur të dhëna të detajuara për secilin produkt të testuar (aFRR dhe mFRR në të dyja drejtimet) lidhur me kërkesën e OST, ofertat e OShB-ve, sasinë e kontraktuar të kapacitetit rezervë, çmimet e kapacitetit rezervë dhe kostot e OST. Të dhënat e rezultuara janë paraqitur në total si dhe me bazë orare.

2.1. Pjesëmarrja në testime.

Tabela 1 paraqet pjesëmarrjen e Subjekteve në Ankandin e Angazhimit për Disponueshmëri për muajin janar 2021.

<i>Tabela 1. Pjesëmarrja e Subjekteve në Procesin e Angazhimit për Disponueshmëri.</i>	
JAVA I	
Mënyra e Testimit: Manualisht	
Produkti	Subjektet Pjesëmarrëse
aFRR+	Devoll Hydropower sh.a; KESH sh.a; Ayen As Energji sh.a
aFRR-	Devoll Hydropower sh.a; KESH sh.a; Ayen As Energji sh.a
mFRR+	Devoll Hydropower sh.a; KESH sh.a; Ayen As Energji sh.a
mFRR-	Devoll Hydropower sh.a; KESH sh.a; Ayen As Energji sh.a
JAVA II	
Mënyra e Testimit: Manualisht	
Produkti	Subjektet Pjesëmarrëse
aFRR+	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
aFRR-	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
mFRR+	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
mFRR-	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
JAVA III	
Mënyra e Testimit: Manualisht	
Produkti	Subjektet Pjesëmarrëse
aFRR+	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
aFRR-	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
mFRR+	Devoll Hydropower sh.a;
mFRR-	Devoll Hydropower sh.a;


2.2. Kërkesa e OST, Ofertat e OShB-ve dhe sasia e kontraktuar.

Testimet e kryera gjatë fazës Dry Run kanë nxjerrë në pah mundësitë e OST për prokurimin e kapacitetit rezervë në tregun shqiptar të balancimit si dhe kanë identifikuar ofruesit potencialë për ofrimin e këtyre shërbimeve. Gjithashtu këto testime kanë mundësuar krijimin e një tabloje më të qartë mbi sasinë e mundshme që mund të ofrojnë këto ofrues si dhe sasinë e mundshme që OST mund të prokurojë në tregun shqiptar të balancimit.

Në vijim janë paraqitur grafikisht rezultatet e testimeve të kryera përgjatë muajit janar 2021 ku pjesëmarrësit e tregut të regjistruar si OShB për fazën Dry Run kanë qenë

pjesë e testimeve për prokurimin e kapacitetit rezervë për aFRR dhe mFRR në të dyja drejtimet. Grafiku 1 paraqet Kërkesën totale të OST, Ofertat totale të OShB-ve dhe sasinë totale të kontraktuar për secilën javë gjatë muajit janar 2021, për kapacitetin rezervë të secilit produkt.


Grafiku 1. Kërkesa totale e OST, Ofertat totale të OShB si dhe Sasia totale e kontraktuar e kapacitetit rezervë për secilën javë për kapacitetin rezervë të secilit produkt gjatë muajit janar 2021.



Siç vihet re nga grafiku Kërkesa javore e OST për kapacitet rezervë përgjithësisht nuk është plotësuar. Aktualisht OST e plotëson kërkesën e saj nëpërmjet marrëveshjes bilaterale me KESH sh.a ndërkohë që pas hyrjes në fuqi të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, OST do e plotësojë këtë kërkesë (diferencën e paplotësuar) nëpërmjet ankandeve shtesë ose në rastin më të keq në interkoneksion.

Grafiku 2 paraqet në përqindje plotësimin e kësaj kërkesë, për secilën javë dhe për secilin produkt. Siç vihet re dhe nga grafiku trendi i plotësimit të Kërkesës së OST për secilin produkt është përgjithësisht trend rënës. Përqindjet e ulëta të plotësimit të kërkesës kanë ardhur si rezultat i ofertave në sasi të ulët të OShB-ve, pjesëmarrjes jo të plotë të tyre si dhe profilizimit të ofertave të OShB-ve pothuajse në të njëjtat profile orare.


Grafiku 2. Plotësimi i kërkesës totale të OST e shprehur në përqindje.



2.2.1. aFRR +

Për kapacitetin rezervë të aFRR në rritje janë parakualifikuar 3 subjekte si OShB për fazën e Dry Run (Devoll Hydropower sh.a, KESH sh.a dhe Ayen AS Energji sh.a). Gjatë testimeve të muajit janar Devoll Hydropower dhe Ayen AS Energji kanë marrë pjesë në treja javët e testimeve ndërsa KESH sh.a ka marrë pjesë vetëm në javën e parë të testimeve. Grafiku 3 paraqet Kërkesën totale të OST, Ofertat totale të OShB-ve dhe sasinë totale të kontraktuar me bazë orare për kapacitetin rezervë të aFRR + gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 3. Kërkesa totale e OST, Ofertat totale të OShB si dhe Sasia totale e kontraktuar e kapacitetit rezervë për aFRR në rritje gjatë muajit janar 2021.



Siç vihet re nga grafiku kërkesa e OST për kapacitetin rezervë të aFRR + nuk është plotësuar plotësisht.

Grafiku 4 paraqet në përqindje plotësimin e kësaj kërkesë me bazë orare, për secilën javë dhe totalin për muajin janar 2021 për kapacitetin rezervë të aFRR+. Siç vihet re dhe nga grafiku Kërkesa orare totale e OST për kapacitet rezervë për aFRR+ gjatë muajit janar 2021 është plotësuar 70-100%. Gjithashtu vihet re një profilizim i plotësimit të kërkesës, ku përgjatë periudhës 24 orëshe ka fasha orare ku kërkesa është plotësuar plotësisht dhe fasha orare ku kërkesa është plotësuar pjesërisht.

Grafiku 4. Plotësimi i kërkesës totale të OST për kapacitet rezervë aFRR+ e shprehur në përqindje.




2.2.2. aFRR –

Për kapacitetin rezervë të aFRR në ulje janë parakualifikuar 3 subjekte si OShB për fazën e Dry Run (Devoll Hydropower sh.a, KESH sh.a dhe Ayen AS Energji sh.a). Gjatë testimeve të muajit janar Devoll Hydropower ka marrë pjesë në të treja javët e testimeve, Ayen AS Energji kanë marrë pjesë në javën e parë dhe të dytë të testimeve, KESH sh.a ka marrë pjesë vetëm në javën e parë të testimeve ndërsa Kurum International nuk ka marrë pjesë në teste.


Grafiku 5 paraqet Kërkesën totale të OST, Ofertat totale të OShB-ve dhe sasinë totale të kontraktuar me bazë orare për kapacitetin rezervë të aFRR - gjatë muajit janar 2021.

Grafiku 5. Kërkesa totale e OST, Ofertat totale të OShB-ve si dhe Sasia totale e kontraktuar e kapacitetit rezervë për aFRR në ulje me bazë orare gjatë muajit janar 2021.



Siç vihet re nga grafiku kërkesa e OST për kapacitetin rezervë të aFRR - nuk është plotësuar plotësisht. Grafiku 6 paraqet në përqindje plotësimin e kësaj kërkesë me bazë orare, për secilën javë dhe totalin për muajin janar 2021 për kapacitetin rezervë të aFRR.

Grafiku 6. Plotësimi i kërkesës totale orare të OST për kapacitet rezervë aFRR- e shprehur në përqindje.




Siç vihet re dhe nga grafiku Kërkesa orare totale e OST për kapacitet rezervë për aFRR- gjatë muajit janar 2021 është plotësuar rreth 80%.

2.2.3. mFRR +


Për kapacitetin rezervë të mFRR në rritje janë parakualifikuar 4 subjekte si OShB për fazën e Dry Run (Devoll Hydropower sh.a, Kurum International sh.a, KESH sh.a dhe Ayen AS Energji sh.a). Gjatë testimeve të muajit janar Devoll Hydropower dhe Ayen AS Energji kanë marrë pjesë në treja javët e testimeve, KESH sh.a ka marrë pjesë vetëm në javën e parë të testimeve ndërsa Kurum International nuk ka marrë pjesë në testime. Grafiku 7 paraqet Kërkesën totale të OST, Ofertat totale të OShB-ve dhe sasinë totale të kontraktuar me bazë orare për kapacitetin rezervë të mFRR + gjatë muajit janar 2021.

Grafiku 7. Kërkesa totale e OST, Ofertat totale të OShB-ve si dhe Sasia totale e kontraktuar e kapacitetit rezervë për mFRR në rritje me bazë orare gjatë muajit janar 2021.



Siç vihet re nga grafiku kërkesa e OST për kapacitetin rezervë të mFRR + nuk është plotësuar plotësisht. Grafiku 8 paraqet në përqindje plotësimin e kësaj kërkesë me bazë orare, për secilën javë dhe totalin për muajin janar 2021 për kapacitetin rezervë të mFRR+.

Grafiku 8. Plotësimi i kërkesës totale orare të OST për kapacitet rezervë mFRR+ e shprehur në përqindje.




Siç vihet re dhe nga grafiku Kërkesa orare e OST për kapacitet rezervë për mFRR+ gjatë muajit janar 2021 është plotësuar rreth 60%.

2.2.4. mFRR -

Për kapacitetin rezervë të mFRR në ulje janë parakualifikuar 4 subjekte si OShB për fazën e Dry Run (Devoll Hydropower sh.a, Kurum International sh.a, KESH sh.a dhe Ayen AS Energji sh.a). Gjatë testimeve të muajit janar Devoll Hydropower ka marrë pjesë në të treja javët e testimeve, Ayen AS Energji kanë marrë pjesë në javën e parë dhe të dytë të testimeve, KESH sh.a ka marrë pjesë vetëm në javën e parë të testimeve ndërsa Kurum International nuk ka marrë pjesë në testime.


Grafiku 9 paraqet Kërkesën totale të OST, Ofertat totale të OShB-ve dhe sasinë totale të kontraktuar me bazë orare për kapacitetin rezervë të mFRR - gjatë muajit janar 2021.

Grafiku 9. Kërkesa totale e OST, Ofertat totale të OShB-ve si dhe Sasia totale e kontraktuar e kapacitetit rezervë për mFRR në ulje me bazë orare gjatë muajit janar 2021.



Siç vihet re nga grafiku kërkesa e OST për kapacitetin rezervë të mFRR - nuk është plotësuar plotësisht. Grafiku 10 paraqet në përqindje plotësimin e kësaj kërkesë me bazë orare, për secilën javë dhe totalin për muajin janar 2021 për kapacitetin rezervë të mFRR-.

Grafiku 10. Plotësimi i kërkesës totale orare të OST për kapacitet rezervë mFRR- e shprehur në përqindje.




Siç vihet re dhe nga grafiku Kërkesa orare e OST për kapacitet rezervë për mFRR- gjatë muajit janar 2021 është plotësuar mbi 90%.

2.3. Çmimet mesatare të kapacitetit rezervë të ofruar dhe të kontraktuar.

Nga testimet e kryera gjatë fazës Dry Run OST dhe pjesëmarrësit e tregut kanë një tablo të qartë lidhur me çmimet e pritshme të kapacitetit rezervë për secilin nga produktet. Në vijim janë paraqitur grafikisht çmimet e rezultuara nga këto teste duke i krahasuar ato me çmimet aktuale si dhe me çmimet e rajonit.


Grafiku 11 paraqet çmimet mesatare të ofruara dhe çmimet mesatare të kontraktuara për kapacitetin rezervë për secilin produkt për secilën javë gjatë muajit janar 2021.

Grafiku 11. Çmimet mesatare të ofruara dhe të kontraktuara për kapacitetin rezervë për secilin produkt për secilën javë gjatë muajit janar 2021.



Grafiku 12 paraqet çmimin mesatar të kapacitetit rezervë për secilin produkt të prokuruar nga OST gjatë muajit janar 2021 duke e krahasuar me çmimin e kapacitetit rezervë nga kontrata aktuale me KESH si dhe çmimin e rajonit (çmimi mesatar në vendet e WB6 sipas deklarimeve të tyre në ENTSO-e).


Grafiku 12. Çmimet mesatare për kapacitetin rezervë për secilin produkt të prokuruar gjatë muajit janar 2021. **Error! Bookmark not defined.**



Siç vihet re dhe nga grafiku çmimet që kanë rezultuar gjatë testeve për kapacitetin rezervë janë dukshëm më të larta se çmimi aktual (kontrata me KESH) dhe çmimi në vendet e rajonit.

Grafiku 13 paraqet çmimin mesatar të kapacitetit rezervë për secilin produkt të prokuruar nga OST për secilën javë gjatë muajit janar 2021 duke e krahasuar me çmimin e kapacitetit rezervë nga kontrata aktuale me KESH si dhe çmimin e rajonit (çmimi mesatar në vendet e WB6 sipas deklarimeve të tyre në ENTSO-e).


Grafiku 13. Çmimet mesatare për kapacitetin rezervë për secilin produkt të prokuruar për secilën javë gjatë muajit janar 2021. Error! Bookmark not defined.




Siç vihet re dhe nga grafiku çmimet që kanë rezultuar gjatë testimeve për kapacitetin rezervë janë dukshëm më të larta se çmimi aktual (kontrata me KESH) dhe çmimi në vendet e rajonit.

Grafikët e mëposhtëm (14-17) paraqesin çmimet orare të kapacitetit rezervë për cilin nga produktet që kanë rezultuar gjatë testimeve të muajit janar.

Grafiku 14. Çmimet mesatare orare për kapacitetin rezervë për aFRR+ të prokuruar gjatë muajit janar 2021.




Grafiku 15. Çmimet mesatare orare për kapacitetin rezervë për aFRR- të prokuruar gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafikët e mësipërn çmimi i kapacitetit rezervë për aFRR në të dyja drejtimet që ka rezultuar nga këto testime gjatë muajit janar 2021 është mjaft i lartë krahasuar me çmimin aktual nga kontrata me KESH dhe çminin e rajonit.

Grafiku 16. Çmimet mesatare orare për kapacitetin rezervë për mFRR+ të prokuruar gjatë muajit janar 2021.



Grafiku 17. Çmimet mesatare orare për kapacitetin rezervë për mFRR- të prokuruar gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafikët e mësipërm çmimi i kapacitetit rezervë për mFRR në të dyja drejtimet që ka rezultuar nga këto testime gjatë muajit janar 2021 është mjaft i lartë krahasuar me çmimin aktual nga kontrata me KESH dhe çmimin e rajonit.

2.4. Kostot e OST sh.a për prokurimin e kapacitetit rezervë.

Bazuar në rezultatet e testimeve gjatë muajit janar 2021 është realizuar një vlerësim mbi kostot e OST lidhur me prokurimin e kapacitetit rezervë duke i krahasuar me kostot aktuale nga kontrata me KESH. Grafiku 18 paraqet kostot totale të OST për muajin janar 2021 për sigurimin e kapacitetit rezervë të secilit produkt dhe kostot aktuale sipas kontratës me KESH.


Grafiku 18. Kostot totale të OST për muajin janar 2021 për sigurimin e kapacitetit rezervë për secilin produkt krahasuar me kostot aktuale sipas kontratës me KESH.



Siç vihet re nga grafiku kostot totale të OST gjatë muajit janar 2021 janë dukshëm më të larta krahasuar me kostot aktuale sipas kontratës me KESH.


Grafiku 19 paraqet kostot totale të OST për secilën javë gjatë muajit janar 2021 duke e krahasuar me kostot aktuale nga kontrata me KESH.

Grafiku 19. Kostot totale të OST për secilën javë gjatë muajit janar 2021 për sigurimin e kapacitetit rezervë për secilin produkt krahasuar me kostot aktuale sipas kontratës me KESH.




Grafikët në vijim (20-24) kostot orare të OST për prokurimin e të kapacitetit rezervë për aFRR dhe mFRR në të dyja drejtimet gjatë muajit janar 2021 duke e krahasuar me kostot sipas kontratës me KESH.


Grafiku 20. Kostot orare të OST gjatë muajit janar 2021 për sigurimin e kapacitetit rezervë për aFRR+ krahasuar me kostot sipas kontratës me KESH.




Grafiku 21. Kostot orare të OST gjatë muajit janar 2021 për sigurimin e kapacitetit rezervë për aFRR- krahasuar me kostot sipas kontratës me KESH.



Grafiku 22. Kostot orare të OST gjatë muajit janar 2021 për sigurimin e kapacitetit rezervë për mFRR+ krahasuar me kostot sipas kontratës me KESH.



Grafiku 23. Kostot orare të OST gjatë muajit janar 2021 për sigurimin e kapacitetit rezervë për mFRR- krahasuar me kostot sipas kontratës me KESH.



Nga grafikët e mësipërm vihet re se kostot e OST për prokurimin e kapacitetit rezervë që kanë rezultuar nga testimet e fazës Dry Run janë dukshëm më të larta krahasuar me kostot sipas kontratës me KESH.

3. Prokurimi i energjisë balancuese gjatë muajit janar 2021.

Prokurimi i energjisë balancuese u testua nëpërmjet kryerjes së Ankandit të Angazhimit për Shpërndarje. Testimet për muajin janar 2021 u realizuan në tre javë, ku rezultatet janë si në vijim për secilën javë testimesh ku janë paraqitur të dhëna të detajuara për secilin produkt të testuar (energji balancuese në rritje dhe energji balancuese në ulje) lidhur me ofertat e OShB-ve, sasinë e aktivizuar të energjisë balancuese, çmimet e energjisë balancuese dhe kostot e OST dhe OShB-ve. Të dhënat e rezultuara janë paraqitur në total si dhe me bazë orare.

3.1. Pjesëmarrja në teste.

Tabela 2 paraqet pjesëmarrjen e Subjekteve në Ankandin e Angazhimit për Disponueshmëri për muajin janar 2021.

<i>Tabela 2. Pjesëmarrja e Subjekteve në Procesin e Angazhimit për Shpërndarje.</i>	
JAVA I (data 14.01.2021)	
Mënyra e Testimit: Manualisht	
Produkti	Subjektet Pjesëmarrëse
Energji balancuese në rritje (aFRR+ + mFRR+)	Devoll Hydropower sh.a; KESH sh.a; Ayen As Energji sh.a
Energji balancuese në ulje (aFRR- + mFRR-)	Devoll Hydropower sh.a; KESH sh.a; Ayen As Energji sh.a
JAVA II (data 21.01.2021)	
Mënyra e Testimit: Manualisht	
Produkti	Subjektet Pjesëmarrëse
Energji balancuese në rritje (aFRR+ + mFRR+)	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
Energji balancuese në ulje (aFRR- + mFRR-)	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
JAVA III (data 28.01.2021)	
Mënyra e Testimit: Manualisht	
Produkti	Subjektet Pjesëmarrëse
Energji balancuese në rritje (aFRR+ + mFRR+)	Devoll Hydropower sh.a; Ayen As Energji sh.a
Energji balancuese në ulje (aFRR- + mFRR-)	Devoll Hydropower sh.a;

3.2. Ofertat e OShB-ve, nevojat e sistemit dhe sasia e aktivizuar.


3.2.1. Energjia balancuese e ofruar.

Testimet e kryera gjatë fazës Dry Run kanë nxjerrë në pah mundësitë e OST për prokurimin e energjisë balancuese në tregun shqiptar të balancimit si dhe kanë identifikuar ofruesit potencialë për ofrimin e këtij shërbimi. Gjithashtu këto teste kanë mundësuar krijimin e një tabloje më të qartë mbi sasinë e mundshme që mund të ofrojnë këto ofrues si dhe sasinë e mundshme që OST mund të prokurojë në tregun shqiptar të balancimit.

Në vijim janë paraqitur grafikisht rezultatet e testimeve të kryera përgjatë muajit janar 2021 ku pjesëmarrësit e tregut të regjistruar si OShB për fazën Dry Run kanë qenë pjesë e testimeve për prokurimin e energjisë balancuese në rritje dhe energjisë balancuese në ulje.

Grafiku 24 paraqet Ofertat e OShB-ve për energjinë balancuese në rritje dhe energjinë balancuese në ulje të ndarë sipas produkteve për ditët e testimeve gjatë muajit janar 2021. Me vlera pozitive shprehet energjia balancuese e aktivizuar në rritje ndërsa me vlera negative shprehet energjia balancuese e aktivizuar në ulje.

Grafiku 24. Ofertat e OShB-ve për energjinë balancuese në rritje (aFRR+ dhe mFRR+) dhe energjinë balancuese në ulje (aFRR- dhe mFRR-) për ditët e testimeve gjatë muajit janar 2021.




3.2.2. Nevojat e sistemit dhe sasia e aktivizuar

Edhe gjatë muajit janar 2021 u realizuan testimet lidhur me energjinë e aktivizuar. Këto testime u kryen teorikisht dhe nuk kishte testime të aktivizimeve reale. Qasja e përdorur për këtë testim ka konsistuar në përcaktimin e nevojave të sistemit (nga nevojat reale) dhe aktivizimin e supozuar të OShB-ve sipas merit-order që ka rezultuar nga Ankandi i Angazhimit për Shpërndarje.


Grafiku 25 paraqet nevojat e sistemit dhe aktivizimin e energjisë balancuese në rritje dhe në ulje sipas produkteve respektive për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021. Me vlera pozitive shprehet energjia balancuese e aktivizuar në rritje ndërsa me vlera negative shprehet energjia balancuese e aktivizuar në ulje. Vlerat e shprehura si “Interkoneksion” tregojnë sasinë e energjisë e cila nuk ka qenë e mundur të aktivizohet nga ofertat e OShB-ve në tregun balancues (mungesë ofertash) dhe është supozuar se shërbimi është marrë në interkoneksion.

Grafiku 25. Nevojat e sistemit dhe energjia balancuese e aktivizuar për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.




Grafikët në vijim (26-28) paraqesin nevojat e sistemit dhe aktivizimin e energjisë balancuese në rritje dhe në ulje me bazë orare sipas produkteve respektive për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021. Me vlera pozitive shprehet energjia balancuese e aktivizuar në rritje ndërsa me vlera negative shprehet energjia balancuese e aktivizuar në ulje. Vlerat e shprehura si “Interkoneksion” tregojnë sasinë e energjisë e cila nuk ka qenë e mundur të aktivizohet nga ofertat e OShB-ve në tregun balancues (mungesë ofertash) dhe është supozuar se shërbimi është marrë në interkoneksion.


Grafiku 26. Nevojat e sistemit dhe energjia balancuese e aktivizuar për datën 14.01.2021.



Grafiku 27. Nevojat e sistemit dhe energjia balancuese e aktivizuar për datën 21.01.2021.



Grafiku 28. Nevojat e sistemit dhe energjia balancuese e aktivizuar për datën 28.01.2021.




3.3. Çmimet mesatare të energjisë balancuese të ofruar dhe të aktivizuar.

Nga testimet e kryera gjatë fazës Dry Run OST dhe pjesëmarrësit e tregut kanë një tablo të qartë lidhur me çmimet e pritshme të energjisë balancuese për secilin drejtim. Në vijim janë paraqitur grafikisht çmimet e rezultuara nga këto testime duke i krahasuar ato me çmimet aktuale si dhe me çmimet e rajonit.


Grafiku 29 paraqet çmimet mesatare (mesatare e ponderuar) të ofruara dhe çmimet mesatare (mesatare e ponderuar) të energjisë balancuese të aktivizuar për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.

Grafiku 29. Çmimet mesatare të energjisë balancuese të ofruar dhe energjisë balancuese të aktivizuar për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.



Grafiku 30 paraqet çmimet mesatare të energjisë balancuese të aktivizuar në secilin drejtim për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 30. Çmimet mesatare të energjisë balancuese të aktivizuar në secilin drejtim për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.



Siç vihet re nga grafiku çmimi i energjisë balancuese në ulje është dukshëm më i ulët se çmimi i energjisë balancuese në rritje.


Grafiku 31 paraqet çmimet mesatare të energjisë balancuese që kanë rezultuar nga testimet në tregun balancues duke i krahasuar me çmimet mesatare të energjisë balancuese sipas kontratës me KESH si dhe çmimet mesatare të rajonit për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.

Grafiku 31. Çmimet mesatare të energjisë balancuese të rezultuara nga testimet krahasuar me çmimet sipas kontratës me KESH dhe çmimet e rajonit për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.




Grafikët në vijim (32-34) paraqesin çmimet mesatare orare për energjinë balancuese që kanë rezultuar nga testimet e Dry Run duke i krahasuar me çmimet mesatare orare sipas kontratës me KESH dhe çmimet mesatare orare të rajonit për secilën ditë testi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 32. Çmimet mesatare të energjisë balancuese për datën 14.01.2021.



Grafiku 33. Çmimet mesatare të energjisë balancuese për datën 21.01.2021.




Grafiku 34. Çmimet mesatare të energjisë balancuese për datën 28.01.2021.



3.3.1. Energjia Balancuese në Rritje.

Grafiku 35 paraqet çmimet mesatare të energjisë balancuese në rritje që kanë rezultuar nga testimet në tregun balancues duke i krahasuar me çmimet mesatare të energjisë balancuese sipas kontratës me KESH si dhe çmimet mesatare të rajonit për secilën ditë testimesh përgjatë muajit janar 2021.


Grafiku 35. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në rritje të rezultuara nga testimet krahasuar me çmimet sipas kontratës me KESH dhe çmimet e rajonit për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku çmimi mesatar i energjisë balancuese në rritje që ka rezultuar nga testimet e Dry Run është më i lartë se çmimi mesatar sipas kontratës me KESH dhe çmimi mesatar i rajonit.

Grafikët në vijim (36-38) paraqesin çmimet mesatare orare për energjinë balancuese që kanë rezultuar nga testimet e Dry Run duke i krahasuar me çmimet mesatare orare sipas kontratës me KESH dhe çmimet mesatare orare të rajonit për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 36. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në rritje për datën 14.01.2021.



Grafiku 37. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në rritje për datën 21.01.2021.




Grafiku 38. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në rritje për datën 28.01.2021.



3.3.2. Energjia Balancuese në Ulje.

Grafiku 39 paraqet çmimet mesatare të energjisë balancuese në ulje që kanë rezultuar nga testimet në tregun balancues duke i krahasuar me çmimet mesatare të energjisë balancuese sipas kontratës me KESH si dhe çmimet mesatare të rajonit për secilën ditë testimesh përgjatë muajit janar 2021.


Grafiku 39. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në ulje të rezultuara nga testimet krahasuar me çmimet sipas kontratës me KESH dhe çmimet e rajonit për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku çmimi mesatar i energjisë balancuese në ulje që ka rezultuar nga testimet e Dry Run është në nivele të pranueshme duke pësuar një rënie në testimet e datës 14 janar dhe një rritje në testimet e datave 21 dhe 28 janar krahasuar me çmimet aktuale nga kontrata me KESH. Ndërkohë që krahasuar me çmimet e rajonit është dukshëm më i ulët.

Grafikët në vijim (40-42) paraqesin çmimet mesatare orare për energjinë balancuese në ulje që kanë rezultuar nga testimet e Dry Run duke i krahasuar me çmimet mesatare orare sipas kontratës me KESH dhe çmimet mesatare orare të rajonit për secilën ditë testi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 40. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në ulje për datën 14.01.2021.



Grafiku 41. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në ulje për datën 21.01.2021.




Grafiku 42. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në ulje për datën 28.01.2021.



3.4. Kostot e OST sh.a dhe OShB-ve për aktivizimin e energjisë balancuese.

Bazuar në rezultatet e testimeve gjatë muajit janar 2021 është realizuar një vlerësim mbi kostot e OST dhe OShB-ve (të ardhurat e OST) lidhur me prokurimin e energjisë balancuese për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021. Grafiku 43 paraqet kostot totale të OST dhe OShB-ve për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021 për prokurimin e energjisë balancuese.

Grafiku 43. Kostot e OST dhe OShB-ve për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021 për prokurimin e energjisë balancuese.




Siç vihet re nga grafiku kostot e OST për prokurimin e energjisë balancuese krahasuar me të ardhurat nga prokurimi i energjisë balancuese (kostot e OShB-ve) janë relativisht të larta, duke përjashtuar datën 28 janar. Kjo tregon se pozicioni financiar i OST gjatë testimeve nuk ka dalë i kënaqshëm. Megjithatë është i nevojshëm edhe krahasimi me kostot dhe të ardhurat aktuale për të parë realisht pozicionin financiar të OST.

3.4.1. Kostot e OST sh.a

OST sh.a paguan OShB-të për aktivizimin e energjisë balancuese në rritje dhe paguhet nga OShB-të për aktivizimin e energjisë balancuese në ulje. Grafiku 44 paraqet kostot totale të OST për prokurimin e energjisë balancuese që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot sipas kontratës me KESH për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 44. Kostot e OST dhe OShB-ve për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021 për prokurimin e energjisë balancuese.




Siç vihet re nga grafiku kostot e OST që kanë rezultuar nga testimet janë dukshëm më të lartat se kostot e OST sipas kontratës me KESH duke përjashtuar datën 21 janar ku kosto e rezultuara nga testimet janë më të ulëta se kostot aktuale.

Grafikët në vijim (45-47) paraqesin kostot orare të OST krahasuar me kostot orare sipas kontratës me KESH për çdo ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 45. Kostot orare të OST për datën 14.01.2021.



Grafiku 46. Kostot orare të OST për datën 21.01.2021.




Grafiku 47. Kostot orare të OST për datën 28.01.2021.



3.4.2. Kostot e OShB-ve

OShB-të paguajnë OST sh.a për aktivizimin e energjisë balancuese në ulje dhe paguhen nga OST sh.a për aktivizimin e energjisë balancuese në rritje. Grafiku 48 paraqet kostot orare të OShB-ve për prokurimin e energjisë balancuese që kanë rezultuar nga testimet për çdo ditë testimi gjatë muajit janar 2021.

Grafiku 48. Kostot orare të OShB për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.



4. Çmimi i disbalancave dhe kostot nga disbalancat gjatë muajit janar 2021.


Testimet e kryera gjatë fazës Dry Run kanë mundësuar krijimin e një tabloje të qartë lidhur me çmimin e disbalancave si dhe kostot e OST dhe PPB-ve që rrjedhin prej tyre. Gjatë muajit janar OST paralelisht me testimet ka analizuar skenarë të ndryshëm lidhur me koeficientin nxitës dhe ka arritur në përcaktimin e koeficientëve paraprakë të cilët janë pjesë e propozimeve për ndryshime në Rregullat e TSHB që do të përcillen në ERE. Duke marrë në konsideratë koeficientët e propozuar nga OST si dhe të dhënat nga testimet e muajit janar në vijim janë paraqitur skenarët respektiv.

4.1. Çmimi i disbalancës.

4.1.1. Çmimi i disbalancës me komponente nxitëse të barabartë me zero.

Grafiku 49 paraqet çmimin mesatar të disbalancave pozitive dhe disbalancave negative për secilën ditë testimesh krahasuar me çmimet aktuale. Çmimi i Disbalancës Pozitive është çmimi me të cilin OST paguan PPB-të me disbalanca pozitive ndërkohë që Çmimi i Disbalancës Negative është Çmimi me të cilin PPB-të me disbalanca negative paguajnë OST. Duke qenë se koeficienti nxitës do të konsiderohet i barabartë me zero çmimi i disbalancës pozitive dhe disbalancës negative për këtë fazë do të jetë i barabartë.


Grafiku 49. Çmimi mesatar i disbalancës që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku çmimi mesatar i disbalancës pozitive të rezultuar nga testimet është dukshëm më i lartë se çmimi mesatar aktual i disbalancës pozitive, çfarë nënkupton se OST do të paguajë më shumë për disbalancat pozitive. Ndërkohë që sa i përket çmimit mesatar të disbalancës negative që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin mesatar aktual të disbalancës negative mund të themi se rritja në këtë nivel është brenda pritshmërive.

Grafikët në vijim (50 - 52) paraqesin çmimet orare të disbalancës që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimet aktuale të disbalancës pozitive dhe negative për secilën ditë testi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 50. Çmimi i disbalancës që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual për datën 14.01.2021.



Grafiku 51. Çmimi i disbalancës që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual për datën 21.01.2021.



Grafiku 52. Çmimi i disbalancës që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual për datën 28.01.2021.



4.1.2. Çmimi i disbalancës me koeficientët e propozuar.

Gjatë muajit janar OST ka analizuar skenarë të ndryshëm lidhur me koeficientin nxitës dhe ka arritur në përcaktimin e koeficientëve paraprakë të cilët janë pjesë e propozimeve për ndryshime në Rregullat e TSHB që do të përcillen në ERE. Duke marrë në konsideratë koeficientët e propozuar nga OST si dhe të dhënat nga testimet e muajit janar në vijim janë kryer llogaritjet e çmimit të disbalancës me koeficientët e propozuar.

Në përcaktimin e këtyre koeficientëve OST ka marrë në konsideratë ndikimin e disbalancave respektive në balancën e sistemit duke nxitur ose dekurajuar pjesëmarrësit sipas rasteve. Fillimisht janë identifikuar rastet siç janë paraqitur në tabelën 3:

Tabela 3. Rastet e marra në konsideratë për përcaktimin e komponentes nxitëse.

Rasti	Gjendja e Sistemit	Lloji i Disbalancës		Komponente nxitëse e propozuar	
		Pozitive	Përkeqëson gjendjen e sistemit	A	B
1	+1 (Sistemi ka tepricë)	Pozitive	Përkeqëson gjendjen e sistemit	0.5 * P _{E.Bal}	
		Negative	Përmirëson gjendjen e sistemit	0.2 * P _{E.Bal}	
2	-1 (Sistemi ka mungesë)	Pozitive	Përmirëson gjendjen e sistemit	0.2 * P _{E.Bal}	
		Negative	Përkeqëson gjendjen e sistemit	0.5 * P _{E.Bal}	
3	0 (Sistemi është në balancë)	Pozitive	Përkeqëson gjendjen e sistemit	0.1 * P _{Mes.Bal}	
		Negative	Përkeqëson gjendjen e sistemit	0.1 * P _{Mes.Bal}	
4	2 (Sistemi ka disbalancë të dyanëshme)	Pozitive	Përkeqëson gjendjen e sistemit	0.1 * P _{E.Bal}	0.1 * P _{Mes.Bal}
		Negative	Përkeqëson gjendjen e sistemit	0.1 * P _{Mes.Bal}	0.1 * P _{E.Bal}

Rasti 1: Sistemi ka tepricë:

PPB që shkakton disbalancë pozitive ndikon në përkeqësimin e balancës së sistemit, për këtë arsye ajo duhet të dekurajohet për kryerjen e një disbalance të tillë me një çmim të ulët.

PPB që shkakton disbalancë negative ndikon në përmirësimin e balancës së sistemit, për këtë arsye ajo duhet të inkurajohet për kryerjen e një disbalance të tillë me një çmim jo shumë të lartë.

Rasti 2: Sistemi ka mungesë:

PPB që shkakton disbalancë pozitive ndikon në përmirësimin e balancës së sistemit, për këtë arsye ajo duhet të inkurajohet për kryerjen e një disbalance të tillë me një çmim të lartë.

PPB që shkakton disbalancë negative ndikon në përkeqësimin e balancës së sistemit, për këtë arsye ajo duhet të dekurajohet për kryerjen e një disbalance të tillë me një çmim të lartë.

Rasti 3: Sistemi është në balancë:

PPB që shkakton disbalancë pozitive dhe PPB që shkakton disbalancë negative ndikojnë njëlloj përkeqësimin e balancës së sistemit, por duke qenë se sistemi është në balancë ky ndikim nuk është i madh, PPB duhet të dekurajohen njëlloj, me një çmim pak më të ulët në rastin e disbalancës pozitive dhe një çmim pak më të lartë në rastin e disbalancës negative.

Rasti 4: Sistemi ka disbalancë të dyanëshme:

A: Në rast se Çmimi mesatar i energjisë balancuese është më i lartë se Çmimi i energjisë balancuese në ulje.

B: Në rast se Çmimi mesatar i energjisë balancuese është më i ulët se Çmimi i energjisë balancuese në ulje.

PPB që shkakton disbalancë pozitive dhe PPB që shkakton disbalancë negative ndikojnë njëllorj përkeqësimin e balancës së sistemit, por duke qenë se sistemi është në disbalancë të dyanëshme ky ndikim nuk është i madh, PPB duhet të dekurajohen njëllorj, me një çmim pak më të ulët në rastin e disbalancës pozitive dhe një çmim pak më të lartë në rastin e disbalancës negative.

Në vijim janë llogaritur çmimet e disbalancës si dhe kostot e OST dhe PPB-ve me koeficientët e propozuar nga OST duke marrë në konsideratë testimet e zhvilluara gjatë muajit janar. Tabela 4 paraqet gjendjen orare të sistemit si dhe koeficientët e përdorur për llogaritjen e çmimit të disbalancës për secilën datë testimesh gjatë muajit janar.

Tabela 4. Gjendja e Sistemit dhe koeficientët për secilën datë testimesh gjatë muajit janar.


Ora	14.01.2021			21.01.2021			28.01.2021		
	Gjendja e Sistemit	Koeficienti ¹		Gjendja e Sistemit	Koeficienti		Gjendja e Sistemit	Koeficienti	
		Disb. Poz	Disb. Neg		Disb. Poz	Disb. Neg		Disb. Poz	Disb. Neg
1	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
2	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
3	0	0.1	0.1	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
4	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
5	1	0.5	0.2	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
6	1	0.5	0.2	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
7	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
8	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5
9	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5
10	1	0.5	0.2	-1	0.2	0.5	-1	0.2	0.5
11	1	0.5	0.2	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2
12	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
13	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
14	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
15	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
16	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
17	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	-1	0.2	0.5
18	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
19	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	-1	0.2	0.5
20	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
21	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
22	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	-1	0.2	0.5
23	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2
24	-1	0.2	0.5	1	0.5	0.2	1	0.5	0.2

¹ Pjesë e komponentes nxitëse Sipas Tabelës 3.

4.1.2.1.Çmimi i Disbalancës Pozitive

Grafiku 53 paraqet çmimin mesatar të disbalancave pozitive për secilën ditë testimesh krahasuar me çmimin mesatar aktual dhe çmimin mesatar kur komponentja nxitëse është e barabartë me zero. Çmimi i Disbalancës Pozitive është çmimi me të cilin OST paguan PPB-të me disbalanca pozitive. Si koeficientë janë përdorur koeficientët e tabelës 4.


Grafiku 53. Çmimi mesatar i disbalancës pozitive që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin mesatar aktual dhe çmimin mesatar me komponenten nxitëse të barabartë me zero për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku çmimi mesatar i disbalancës pozitive të rezultuar nga testimet me komponenten nxitëse të barabartë me zero është më i lartë se çmimi i llogaritur me komponentet nxitëse të propozuara nga OST.

Grafikët në vijim (54 - 56) paraqesin çmimet orare të disbalancës pozitive që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual të disbalancës pozitive dhe çmimin me komponentet nxitëse të barabartë me zero për secilën ditë testi gjatë muajit janar.


Grafiku 54. Çmimi i disbalancës pozitive që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual dhe çmimin me komponenten nxitëse të barabartë me zero për datën 14.01.2021.



Grafiku 55. Çmimi i disbalancës pozitive që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual dhe çmimin me komponenten nxitëse të barabartë me zero për datën 21.01.2021.




Grafiku 56. Çmimi i disbalancës pozitive që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual dhe çmimin me komponenten nxitëse të barabartë me zero për datën 28.01.2021.



4.1.2.2.Çmimi i Disbalancës Negative

Grafiku 57 paraqet çmimin mesatar të disbalancave negative për secilën ditë testimesh krahasuar me çmimin mesatar aktual dhe çmimin mesatar kur komponentja nxitëse është e barabartë me zero. Çmimi i Disbalancës Negative është Çmimi me të cilin PPB-të me disbalanca negative paguajnë OST. Si koeficientë janë përdorur koeficientët e tabelës 4.


Grafiku 57. Çmimi mesatar i disbalancës negative që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin mesatar aktual dhe çmimin mesatar me komponenten nxitëse të barabartë me zero për secilën ditë testimesh gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku çmimi mesatar i disbalancës negative të rezultuar nga testimet me komponenten nxitëse të barabartë me zero është më i ulët se çmimi i llogaritur me komponentet nxitëse të propozuara nga OST.

Grafikët në vijim (58-60) paraqesin çmimet orare të disbalancës negative që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual të disbalancës negative dhe çmimin me komponentet nxitëse të barabartë me zero për secilën ditë testi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 58. Çmimi i disbalancës negative që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual dhe çmimin me komponenten nxitëse të barabartë me zero për datën 14.01.2021.



Grafiku 59. Çmimi i disbalancës negative që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual dhe çmimin me komponenten nxitëse të barabartë me zero për datën 21.01.2021.



Grafiku 60. Çmimi i disbalancës negative që ka rezultuar nga testimet krahasuar me çmimin aktual dhe çmimin me komponenten nxitëse të barabartë me zero për datën 28.01.2021.



4.2. Kostot e OST dhe PPB-ve që rrjedhin nga Disbalancat.

Qëllimi i tregut balancues është që t'i mundësojë OST në çdo moment mundësi për balancimin e sistemit. Për të arritur këtë qëllim OST prokuron kapacitet rezervë dhe energji balancuese në mënyrë që të rikuperojnë balancën e sistemit pas disbalancave të kryera nga PPB-të. Duke qenë se PPB-të janë shkaktarët e krijimit të disbalancave ata do të jenë edhe përgjegjës për mbulimin e kostove të OST që rrjedhin prej këtij procesi. E thënë ndryshe PPB-të do të jenë përgjegjës për çdo kosto që i shkaktohet OST si pasojë e disbalancave të shkaktuara nga PPB-të.


Në vijim janë paraqitur kostot e OST dhe PPB lidhur me disbalancat duke marrë në konsideratë komponenten nxitëse të barabartë me zero dhe komponentet nxitëse të propozuara nga OST.

4.2.1. Kostot e OST.

4.2.1.1. Kostot e OST me komponente nxitëse të barabartë me zero.

OST sh.a paguan PPB-të për disbalancat pozitive dhe paguhet nga PPB-të për disbalancat negative. Grafiku 61 paraqet kostot totale të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale për disbalancat për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 61. Kostot e OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku, kostot e OST për disbalancat variojnë, herë janë më të larta se kostot aktuale (datat 21,28) dhe herë janë më të më të ulëta se kostot aktuale (data 14).

Grafikët në vijim (62-64) paraqesin kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale të OST për disbalancat për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 62. Kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare të OST për disbalancat për datën 14.01.2021.



Grafiku 63. Kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare të OST për disbalancat për datën 21.01.2021.




Grafiku 64. Kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare të OST për disbalancat për datën 28.01.2021.



4.2.1.2. Kostot e OST me koeficientët e propozuar.

Në vijim janë llogaritur kostot e OST me çmimet e disbalancës me komponenten nxitëse sipas koeficientëve të propozuar nga OST. Grafiku 65 paraqet kostot e OST për disbalancat me komponenten nxitëse sipas koeficientëve të propozuar.


Grafiku 65. Kostot e OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku, kostot e OST që rezultojnë me koeficientët e propozuar për disbalancat janë pothuajse në të njëjtat nivele me kostot aktuale.

Grafikët në vijim (62-64) paraqesin kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale të OST për disbalancat për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 66. Kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare të OST për disbalancat për datën 14.01.2021.



Grafiku 67. Kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare të OST për disbalancat për datën 21.01.2021.



Grafiku 68. Kostot orare të OST për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare të OST për disbalancat për datën 28.01.2021.




4.2.2. Kostot e PPB-ve.

4.2.2.1. Kostot e PPB-ve me komponente nxitëse të barabartë me zero.

Këto kosto të PPB-ve shërbejnë si të ardhura për OST dhe mbulojnë kostot e OST për prokurimin e energjisë balancuese. PPB-të paguajnë OST sh.a për disbalancat negative dhe paguhen nga OST sh.a për disbalancat pozitive. Grafiku 69 paraqet kostot totale të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale për disbalancat për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 69. Kostot e PPB-ve për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku, kostot e PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat krahasuar me kostot aktuale të PPB-ve (të ardhurat e OST) kanë rezultuar më të larta.

Grafikët në vijim (70-72) paraqesin kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 70. Kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare për disbalancat për datën 14.01.2021.



Grafiku 71. Kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare për disbalancat për datën 21.01.2021.




Grafiku 72. Kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare për disbalancat për datën 28.01.2021.



4.2.2.2. Kostot e PPB-ve me koeficientët e propozuar.

Në vijim janë llogaritur kostot e PPB-ve me çmimet e disbalancës me komponenten nxitëse sipas koeficientëve të propozuar nga OST. Grafiku 73 paraqet kostot e PPB-ve për disbalancat me komponenten nxitëse sipas koeficientëve të propozuar.


Grafiku 73. Kostot e PPB-ve për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.




Siç vihet re nga grafiku, kostot e PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat krahasuar me kostot aktuale të PPB-ve (të ardhurat e OST) kanë rezultuar më të larta.

Grafikët në vijim (74-76) paraqesin kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat për secilën ditë testimi gjatë muajit janar 2021.


Grafiku 74. Kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare për disbalancat për datën 14.01.2021.



Grafiku 75. Kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare për disbalancat për datën 21.01.2021.



Grafiku 76. Kostot orare të PPB-ve (të ardhurat e OST) për disbalancat që kanë rezultuar nga testimet krahasuar me kostot aktuale orare për disbalancat për datën 28.01.2021.



5. Përfundime

Testimet e kryera gjatë muajit janar mundësuan një tablo më të qartë rreth pritshmërive të tregut balancues, nivelit të plotësimit të kërkesës së OST për kapacitet rezervë dhe energji balancuese, çmimet e kapacitetit rezervë, energjisë balancuese dhe disbalancave si dhe kostot e OST dhe pjesëmarrësve të tregut (OShB dhe PPB). Gjithashtu gjatë muajit janar paralelisht me testimet OST ka analizuar vlerat e mundshme të komponentes nxitëse duke arritur të sjellë propozimet lidhur me këtë komponente.

Prokurimi i kapacitetit rezervë.

1. Pjesëmarrja e Subjekteve të kualifikuar si OShB në testimet për prokurimin e kapacitetit rezervë gjatë muajit janar 2021 nuk ka qenë e kënaqshme.
2. Nga testimet ka rezultuar se kërkesa e OST është plotësuar pjesërisht, ofertat e OShB-ve jo gjithmonë mbuluan kërkesën e OST.
3. Çmimet mesatare të kapacitetit rezervë që rezultuan nga testimet ishin relativisht të larta krahasuar me çmimet aktuale apo çmimet e rajonit.
4. Kostot e OST për prokurimin e kapacitetit rezervë që rezultuan nga testimet gjatë muajit janar krahasuar me ato aktuale janë dukshëm më të larta.

Prokurimi i energjisë balancuese.

1. Pjesëmarrja e Subjekteve të kualifikuar si OShB në testimet për prokurimin e energjisë balancuese gjatë muajit janar 2021 nuk ka qenë e kënaqshme.
2. Nga testimet ka rezultuar se nevojat e sistemit përgjithësisht janë plotësuar.
3. Çmimet mesatare të energjisë balancuese në rritje që rezultuan nga testimet ishin relativisht të larta krahasuar me çmimet aktuale apo çmimet e rajonit. Çmimet mesataret të energjisë balancuese në ulje që rezultuan nga testimet ishin pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me çmimet aktuale apo çmimet e rajonit.
4. Kostot e OST për prokurimin e energjisë balancuese që rezultuan nga testimet gjatë muajit janar krahasuar me ato aktuale janë dukshëm më të larta.

Çmimi i disbalancës dhe kostot e OST dhe PPB-ve nga disbalancat

1. Për llogaritjen e çmimit të disbalancës dhe kostove që rrjedhin prej disbalancave janë marrë në shqyrtim dy raste:
 - a. Me komponente nxitëse të barabartë me zero;
 - b. Me komponente nxitëse sipas propozimeve të OST;
2. Në të dy rastet çmimet mesatare të disbalancës pozitive dhe negative që rezultuan nga testimet ishin relativisht të larta krahasuar me çmimet aktuale.
3. Kostot e OST dhe PPB-ve:
 - a. PPB-të që shkaktojnë disbalanca pozitive do të paguhen nga OST me çmimin e energjisë balancuese që do të rezultojë nga tregu balancues. Kostot e OST krahasuar me kostot aktuale kanë rezultuar pothuajse në të njëjtat nivele.
 - b. PPB-të që shkaktojnë disbalancat negative do të paguajnë OST me çmimin e energjisë balancuese që do të rezultojë nga tregu balancues. Kostot e PPB-ve krahasuar me kostot aktuale kanë rezultuar më të larta.